

PARATHËNIE

Punimet që përmbahen në këtë vëllim studimor reflektojnë në pikëpamje të ndryshme çështje të njohjes së shkrimtarisë dhe të veprave të E. Haxhiademit, një autor që me përpilimet që realizoi në dekadat e para të shekullit të kaluar, u bë pjesë e një tradite të veçantë letrare e shkrimore.

Falë formimit të tij, por dhe interesit të spikatur për letërsinë klasike e botën antike, u realizuan vepërza që përkujtojnë figura të rëndësishme në antikitet, por dhe të historisë sonë kombëtare.

Grishjet për ta konkretizuar homazhin ndaj tij në kontribute e kumtesa mjaft të arrira do të gjinden të pasqyruara dhe në këtë vëllim, që përmban pikërisht paraqitjet e realizuara pothuaj një vit më parë, me rastin e konferencës shkencore mbarëkombëtare që u organizua nga Departamenti i Studimeve Letrare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë mbi figurën e Etëhem Haxhiademit.

Janë komplekse prirjet e shfaqura në trajtesa të thelluara që i kushtohen analizimit të kontekstit në të cilin u maturuan dhe prirje të shkrimtarisë së Haxhiademit, vlerave që përçojnë me brendinë e tyre veprat më të rëndësishme të tij, po ashtu dhe shqipërimet, ndër të cilat veçojmë “Bukolikata” e Vergilit.

Formimi klasik i Haxhiademit reflektohet në dimensione të ndryshme në përmbajtjen e këtyre veprave, përfshirë ndërtimet e teksteve, vizatimin e personazheve që janë protagoniste në to, por dhe në tekste introductive që u paraprijnë shtjellimeve në elemente dhe formë. Janë cekur mjaft tipare të kësaj shkrimtarie, është parë në vështrim diakronik dhe ecuria e njohjes së kësaj të fundit, bashkë me domosdoshmërinë e ribotimit që u bë konkret para pak kohësh falë nismës dhe punës së kujdesshme përgatitore e filologjike të Arian Lekës, Silvana Lekës, Hortensia Haxhiademit.

Në përbërje të këtij vëllimi do të gjenden trajtesa që orientohen ndaj receptimit të elementeve të botës antike në përpilimet e Haxhiademit, por dhe hulumtime mbi çështje personazhesh që të rimarra në kohë të ndryshme në autorë të ndryshëm, gjejnë reflektim dhe në motivet kryesore të veprave të këtij autori. Është vetë antikiteti, personazhet e toposet e tij që kanë frymëzuar përherë autorë e vepra e një fakt i tillë do të gjendet i reflektuar dhe në vepërzat (tragjeditë) që pasojnë njëra-tjetrën, në një vijimësi që duhet hulumtuar si tërësi procesesh graduale.

Haxhiademi autor, por dhe Haxhiademi shqipëruës, mbeten dy linja të rëndësishme që ofrojnë mundësi jo të pakta hulumtimi dhe qasjesh ndaj krijuesish të tjerë, apo periudhave të afërta që kanë ndikuar dhe në formimin e tij. Në të vërtetë, pikërisht njohja e këtij formimi dhe reflektimi përkatës në përpilimet që mbajnë dhe tituj mjaft domethënës, janë premisa që orientojnë një pjesë të mirë të trajtesave që u paraqitën në konferencë dhe që janë përfshirë dhe në këtë botim të tematizuar.

Motive interesante për nga pikëpamja antropokulturore kanë qenë shtysë që dhe në kumtesat e përmbajtura në vëllimin në fjalë të bëhen objekt tipare personazhesh që janë përjetësuar në vepra madhore të letërsisë botërore, por dhe në tragjeditë e E. Haxhiademit. Duke ruajtur lidhjet me botën antike, duke portretizuar personazhe tipike të saj, autori shfaq dhe tipare origjinaliteti, pasuruar me njohjen e thellë të gjuhës amtare dhe të trashëgimisë leksikore e semantike të saj. Në analiza të thelluara, por dhe në punime që janë bërë pjesë dhe e këtij vëllimi, pasuria e motiveve të përzgjedhura flet qartë për angazhimin në objektivin për ta vlerësuar dhe nxjerrë në një dritë të qartë një personalitet të tillë, përherë në perspektivën e një njohjeje më të thelluar, së cilës i kishte ardhur tashmë koha. Në një vëllim të tillë do të përmbahen dhe trajtesa të nxitura nga qasje të natyrës etnolinguistike, por dhe të prirjeve që bëjnë të mundur përfshirjen e shkencave të ligjërimit në të tilla vëzhgime mbi autorin e veprën.

Studimet dhe interpretimet mbi tekstet introductive të veprave të Haxhiademit, të botuara afërsisht në kohë, por jo përherë të njëjta për nga shtrirja dhe tiparet e ndërtimit, mbeten një tjetër linjë për t'u vënë në konsideratën e studiuesve të veprës së tij, parë dhe në dritën e ndikimeve të mundshme në formë e përmbajtje. Në këtë perspektivë, dhe përpilime të afërta në kohë e të para dhe në prirjen për ta pasur sa më të plotë panoramën e kohës në të cilën jetoi autori kanë gjetur vendin e vet në trajtesa të caktuara.

Le të jetë dhe një botim i tillë, me një përmbajtje të qartë tematike dhe kontribute të orientuara ndaj krijimtarisë dhe shkrimtarisë së Haxhiademit, një homazh kushtuar veprës dhe veprimtarisë së pasur të tij.

Falënderime të përzemërta u takojnë kolegëve të Departamentit të Studimeve Letrare për praninë e çmuar dhe për kontributet e vyera që reflektohen dhe në këtë vëllim. Falënderime të ngrohta shprehim për të gjithë pjesëmarrësit në konferencën shkencore kushtuar Etëhem Haxhiademit, në veçanti për kolegët e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (ASA) si dhe të universiteteve e qendrave kërkimore në Shqipëri dhe atyre në Kosovë.

Prof. as. dr. Evalda Paci
Qershor 2022

